



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 27 maj 2021
Nr. ref.: RK1788/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI183/20

Parashtrues

Naser Husaj

Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit AC. nr. 4568/17, të 18 qershorit 2020

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSVËS

Arta Rama-Hajrizi, kryetare,
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar,
Bekim Sejdiu, gjyqtar,
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare,
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare,
Safet Hoxha, gjyqtar,
Radomir Laban, gjyqtar,
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Naser Husaj, me vendbanim në Pejë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, AC. nr. 4568/17 e 18 qershorit 2020, i cili i është dorëzuar atij më 31 gusht 2020.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, AC. nr. 4568/17 e 18 qershorit 2020, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij, të garantuara me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe nenin 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 16 dhjetor 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 30 dhjetor 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues) Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
7. Më 11 janar 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës së Apelit, në pajtim me Ligjin.
8. Më 18 janar 2021, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Pejë informata përkitazi me datën e pranimit të Aktvendimit të kontestuar nga parashtruesi i kërkesës.
9. Më 26 janar 2021, Gjykata Themelore në Pejë e njoftoi Gjykatën se Aktvendimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 31 gusht 2020.
10. Më 27 janar 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi informata shtesë në Gjykatë.
11. Më 13 prill 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

Hyrje

12. Parashtruesi i kërkesës, në cilësinë e parashtruesit të kërkesës, parashtron për herë të pestë kërkesë në Gjykatë. Më parë ai parashtoi kërkesat KI22/16, KI128/17, KI146/19, KI08/20, KI178/20. Megjithatë, në kërkesën e tanishme KI183/20, objekt i kontestuar është Aktvendimi AC.nr.456/17 i Gjykatës së Apelit, i 18 qershorit 2020, i cili në kërkesat e sipër cekura nuk ishte objekt i shqyrtimit.

Rrjedha e procedurës gjyqësore

13. Më 6 korrik 2006, paditësit S.S. dhe N.SH., nga Peja kundër parashtruesit të kërkesës ushtruan padi në Gjykatën Komunale në Pejë, për shkak të pengimit të posedimit të qetë të paluajtshmërisë, përkatësisht të hapësirës së bodrumit, në sipërfaqe prej 16 m² (metra katror), në ndërtesën e cila është ndërtuar në ngastrën kadastrale nr. 245/14-1610-ZK në Pejë, paluajtshmëria gjendet në ish rrugën Mosha Pijada, tani Bill Clinton, hyrja III, nr. 21/9.
14. Më 5 shtator 2013, Gjykata Themelore në Pejë, nxori Aktvendimin C. nr. 526/06, përmes së cilit aprovoi padinë e paditësve S.S dhe N.Sh. nga Peja dhe vërtetoi se parashtruesi i kërkesës ka penguar paditësit në shfrytëzimin e qetë të paluajtshmërisë në fjalë.
15. Kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, për shkak të vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale.
16. Më 12 mars 2014, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit AC. nr. 3152/13, e prishi Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Pejë C. nr. 526/06 të 5 shtatorit 2013 dhe e ktheu të njëjtin në rigjykim. Gjykata e Apelit, në këtë rast, udhëzoi që gjykata e shkallës së parë të dalë në vendngjarje dhe të vërtetojë se cili është bodrumi nr. 9 (nëntë), ku pretendohet se është bërë pengim posedimi, duke shtuar se vërtetimi duhet të bëhet me prezencën e dëshmitarëve ose me angazhimin e ekspertit përkatës.
17. Më 21 maj 2015, Gjykata Themelore në Pejë, duke vendosur në riprocedurë nxjerrë Aktvendimin C. nr. 368/14, përmes së cilit aprovoi padinë e paditësve S.S. dhe N.Sh. nga Peja dhe vërtetoi se të njëjtit janë penguar nga parashtruesi i kërkesës për ta shfrytëzuar në mënyrë paqësore paluajtshmërinë në fjalë.
18. Kundër këtij aktvendimi parashtruesi i kërkesës kishte ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, për shkak të vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale.
19. Më 25 janar 2016, Gjykata e Apelit, duke vendosur për ankesën e parashtruesit të kërkesës, nxori Aktvendimin Ac. nr. 255/15, përmes së cilit aprovoi ankesën

e tij dhe e prishi Aktvendimin e Gjykatës Themelor në Pejë, të 21 majit 2015, duke konstatuar se gjykata e shkallës së parë nuk i është përmbajtur gjetjeve të kësaj gjykate në Aktvendimin Ac. nr. 3152/13 të 12 marsit 2014.

20. Më 8 shkurt 2017, paditësi N.Sh. e kishte precizuar padinë e tij të parashtruar më 6 korrik 2006.
21. Më 14 shtator 2017, në procedurën të tretë të përsëritur Gjykata Themelore në Pejë, përmes Aktvendimit C. nr. 175/16 aprovoi padinë e paditësit N.Sh. nga Peja, dhe vërtetoi se parashtruesi i kërkesës e ka penguar atë në shfrytëzimin e qetë dhe faktik të paluajtshmërisë së lartcekur, duke prishur muret e brendshme të bodrumit me qëllim të shndërrimit të tij në lokal afarist. Parashtruesi i kërkesës në këtë rast u obligua t'i paguajë paditësit shpenzimet e procedurës në shumën prej 3.174.00 euro, pas plotfuqishmërisë së Aktvendimit.
22. Më 12 tetor 2017, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë, të 14 shtatorit 2017, për shkak të vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
23. Më 18 qershor 2020, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit të kontestuar Ac. nr. 4568/2017, e refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore C. nr. 175/16, të 14 shtatorit 2017, me arsyetimin vijues:

“Pas shikimit të lëndës dhe shqyrtimit të procedurës së zhvilluar nga gjykata e shkallës së parë Gjykata e Apelit ka konstatuar se gjykata ka vepruar sipas vërejtjeve të dhëna nga Gjykata e Apelit në aktvendimin Ac. nr. 2555/15, datë 25.01.2016, më të cilin i është kthyer çështja në rigjykim gjykatës së shkallës së parë. Arsyeja e parë për të cilën i është kthyer çështja mbrapa është veprimi i gjykatës së shkallës së parë në mospërputhje me dispozitat ligjore, duke e shqyrtuar të drejtën e pronësisë mbi pronën kontestuese, edhe pse në fakt nuk është parashtruar padi për vërtetimin e pronësisë, por është paraqitur padi për pengim posedim, në pajtim me Ligjin mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore (LMTHJP), si dhe Ligjin për Procedurën Kontestimore. Ashtu siç ka theksuar Gjykata e Apelit në Aktvendimin e marrë siç është cekur me lartë, neni 480 i LPK-së, thotë se: “Shqyrtimi i çështjes sipas padisë për shkak të pengim posedimit do të kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë. Përfundohet mundësia e shqyrtimit lidhur me të drejtën e posedimit, me bazën juridike, ndërgjegjshmërinë ose pandërgjegjshmërinë e posedimit.” Në pajtim me atë që kjo dispozitë përcakton, gjykata e shkallës së parë pas marrjes së lëndës në shqyrtim, e ka shqyrtuar dhe vërtetuar gjendjen e fundit të posedimit dhe pengimit të bërë, për çka edhe të gjitha pretendimet e tjera të palës se paditur rreth çështjes që dalin jashtë kufizimeve të përcaktuara me nenin 480 të LPK-së, si më lartë refuzohen si të paqëndrueshme. Si rrjedhojë Gjykata e Apelit i rezultoi që gjykata e

shkallës së parë drejtë dhe ligjshëm ka vendosur në këtë çështje kontestimore, duke zbatuar me saktësi dispozitat e neneve 75 dhe 77 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore (LMTHJP) i vitit 1980, i cili ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridik, por edhe të neneve 113.2 lidhur me nenin 114 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (LPDS) që tani është në fuqi.

Mangësitë e aktvendimit të prishur nga Gjykata e Apelit, përmes aktvendimit të cekur më lartë, sipas vërejtjeve të kësaj të fundit, gjykata e shkallës së parë i ka eliminuar edhe me rastin e caktimit të ekspertizës së gjeodezisë dhe daljes në vend të ngjarës. (...).

24. Më 2 shtator 2020, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, kundër aktvendimeve të gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së shkallës së dytë C. nr. 175/16 dhe Ac. nr. 4468/2017, për shkak të vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
25. Më 3 nëntor 2020, Gjykata Supreme me Aktvendimin Rev. nr. 553/2020 e hodhi poshtë si të palejuar kërkesën për revizion të parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se: *“Në bazë të nenit 483.4 të Ligjit të procedurës kontestimore (nr. 03/L-006) është përcaktuar se kundër aktvendimeve në kontestet pengim posedimi revizionit nuk është i lejuar”* Andaj lidhur me hedhjen si të palejuar të revizionit, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi me zbatimin e nenit 221, lidhur me nenin 230 të LPK”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtruesi i kërkesës, pretendon se me Aktvendimin e kontestuar [Ac. nr. 4468/17], të 18 qershorit 2020, i janë shkelur të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenet 53 dhe 54 të Kushtetutës, duke theksuar se *“Gjykata e shkallës së parë në Pejë me aktvendimin C. nr. 175/16 e 14.9.2017 nuk ka vepruar sipas udhëzimeve të Aktvendimit të Gjykatës së Apelit AC-nr-3152/13 të datës 12.3.2014, ku ka kërkuar të vërtetohet se ku gjendet bodrumi nr. 9, dhe nuk e ka vërtetuar se kush ka qenë në posedim të fundit të këtij bodrumi. Gjykata nuk ka dalë në vendngjarje, por vetëm ka ardhë gjeodeti, prandaj nuk është vërtetu...”*.
27. Tutje, parashtruesi shton se përveç kësaj paditësi N.Sh. nuk ka pasur autorizim për të ngritur padi në emër të S.S., në gjykatë, dhe se gjykata e shkallës së parë nuk i ka marrë parasysh dëshmitë e dëshmitarit.
28. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata: të shpallë të pavlefshme Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.175/2016 dhe Aktvendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit, AC.nr.4468/17 të 6 qershorit 2020.

Pranueshmëria e kërkesës

29. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

30. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], që përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

[...]

31. Për më tepër, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç janë të përcaktuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49

[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

32. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë, siç janë cekur më lart, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar për parashtrim të kërkesës në kuadër të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe konteston një akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktvendimin AC. nr. 4468/17 të 6

qershorit 2020, pasi i ka shterur të gjitha mjetet juridike në dispozicion. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur me aktin e autoritetit publik dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit.

33. Megjithatë, përveç kësaj Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht me paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, që përcakton:

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

34. Gjykata, fillimisht thekson që rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GjEDNj) si dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në bazë të dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
35. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta”. (Shih: më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si “qartazi të pabazuar”, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si “qartazi të pabazuara”, Udhëzuesin Praktik të GjEDNj-së për Kriteret e Pranueshmërisë të 31 gushtit 2019; Pjesa III. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 255 deri më 284).
36. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

37. Sa i përket rastit konkret, Gjykata vëren se thelbi i pretendimeve për shkelje të të drejtave të garantuara, ndërlidhet me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe nenin 54 [Mbrotja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, të cilat parashtuesi i kërkesës nuk i shpjegon dhe as nuk i arsyeton më tej.
38. Sa i përket shkeljeve të mësipërme të të drejtave të garantuara me nenin 53 dhe nenin 54 të Kushtetutës, Gjykata rikujton se sipas praktikës së themeluar gjyqësore të GjEDNJ-së, Gjykata e shpall kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar në pajtim me kriterin (iii) të pretendimeve “*të pambështetura apo të paarsyetuara*” kur plotësohet një nga dy kushtet karakteristike, përkatësisht;
- a) kur parashtuesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse kjo është qartazi e dukshme në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit (Shih: në këtë drejtim, rasti i GJEDNJ-së *Trofimchuk kundër Ukrainës (vendim)* nr. 4241/03 i 31 majit 2005, shih gjithashtu *Baillard kundër Francës (vendim)* nr. 6032/04 i 25 shtatorit 2008);
 - b) kur parashtuesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë provat materiale me të cilat do t’i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera zë brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t’ia paraqes Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih rastin KI166/20, parashtues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, 5 janar 2021, paragrafi 42)
39. Në rastin konkret, parashtuesi i kërkesës vetëm pretendon shkelje të neneve 53 dhe 54 të Kushtetutës, por nuk arsyeton ose shpjegon se si ka ardhur deri te shkelja e këtyre neneve, por pretendon se e drejta e parashtuesit të kërkesës ishte shkelur sepse “...Gjykata e shkallës së parë në Pejë me aktvendimin C. nr. 175/16 e 14.9.2017 nuk ka vepruar sipas udhëzimeve të Aktvendimit të Gjykatës së Apelit AC-nr-3152/13 të datës 12.3.2014, ku ka kërkuar të vërtetohet se ku gjendet bodrumi nr. 9, dhe nuk e ka vërtetu se kush ka qenë në posedim të fundit të këtij bodrumi. Gjykata nuk ka dal në vendngjarje, por vetëm ka ardhë gjeodeti, prandaj nuk është vërtetu...”.
40. Përkitazi me këto pretendime, Gjykata vëren se parashtuesi i kërkesës vetëm i përmend nenet përkatëse, por nuk shtjellon më tutje se si dhe përse ka ardhur deri te shkelja e këtyre neneve përkatëse të Kushtetutës. Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtuesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës Kushtetuese KI136/14, parashtues: *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për

papranueshmëri, paragrafi 33; KI187/18 dhe KI 11/19, parashtues: *Muhamet Idrizi* Aktvendim për papranueshmëri, i 29 korrikut 2019, paragrafi 73, dhe së fundmi rastin KI125/19 parashtues: *Ismajl Bajgora*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 marsit 2020, paragrafi 63).

41. Prandaj, Gjkata konstaton se sa i përket pretendimeve të parashtuesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 53 dhe nenin 54 të Kushtetutës, Gjkata konkludon se kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar, sepse këto pretendime cilësohen si pretendime që i takojnë kategorisë (iii) së pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, sepse parashtuesi i kërkesës thjesht ka cituar një ose më shumë dispozita të Konventës ose të Kushtetutës, pa shpjeguar se si janë shkelur ato. Prandaj, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjkata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe të rregullave 39 (2) dhe 59 (b) të Rregullores së punës, më 13 prill 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Radomir Laban




Arta Rama-Hajrizi